



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:102030  
Datë: 23.01.2025  
Numri i dokumentit: 06746104

C. nr. 1891/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.G. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson B.M. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-P.K. Drejtoria e Përgjithshme, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimin e pagës së trembëdhjetë vlera e kontestit 1,000 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 22.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit A.G. nga Prizreni.
- II. DETYROHET e paditura P.K. që paditësit, në emër të kompensimit të një page mujore (pagesës së trembëdhjetë) t'ia paguaj shumën nga 534.18 euro (pesëqind e tridhjetë e katër euro e tetëmbëdhjetë cent), për vitet 2020 dhe 2021, në shumë të përgjithshme prej 1.068,36 euro (njëmijë e gjashtëdhjetë e tetë euro e tridhjetë e gjashtë cent), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 27.03.2024, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- III. REFUZHET e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit, përtej shumës së gjykuar si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë për kompensimin e pagës së trembëdhjetë për vitin 2022 dhe 2023, në lartësi të një page mujore 534.18 € (pesëqind e tridhjetë e katër euro e tetëmbëdhjetë cent).
- IV. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej njëqind e tridhjetë e katër euro (134.00 €), në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi A.G. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate përmes të autorizuarit të tij av. B.M. ka parashtruar padi kundër të paditurës P.K. të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore e Republikës së Kosovës me seli në Prishtinë, përmes së cilës ka kërkuar kompensimin e pagës së trembëdhjetë për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 në shumë prej 2,136.72 euro, të gjitha me

kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga momenti i paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore të cilat do ti precizoj përfaqësuesi i autorizuar.

Në referatin e padisë ka theksuar se paditësi A.G. nga Prizreni, sipas vërtetimit të punësimit me nr. të referencës 05/3-04SRR-A/00047/2024, të datës 26.01.2024, është në marrëdhënie pune pranë Policisë së Kosovës me orar të plotë që nga data 11.11.2019, ku edhe vazhdon të punojë. Paditësi si i punësuar në P.K. duke u mbështetur në Ligjin e Punës, Ligjin për Policinë e Kosovës, UA Nr.02/2018, mbi Marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës neni 29 par.2 dhe UA Nr.01/2021, mbi Marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës neni 30 par.2, të njëjtit i takon shpërblimi i një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt në fund të vitit bazuar në vlerësimet e performancës së punës dhe paditësit i janë mohuar këto të drejta edhe përkundër performancës shumë të mirë të treguar gjatë këtyre viteve.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij më dt.04.03.2024, i është drejtuar punëdhënësit të tij MPB-së, me kërkesë për kompensimin e pagës së trembëdhjetë si dhe kompensimin e pagës jubilarë.

Ashtu që nga gjykata ka kërkuar që ta obligoj të paditurën – P.K. e Kosovës që në emër të kompensimit pagës së trembëdhjetë për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023 në shumë prej 2,136.72 euro, të gjitha me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga momenti i paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare.

E paditura brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në padi, ku e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar. E paditura nuk e ka kontestuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura duke u mbështetur në vërtetimet e punësimit të lëshuara nga e paditura. Kërkesëpadinë e paditësit sa i përket kompensimit të pagës së 13-të, e ka kundërshtuar pasi që e njëjta nuk është realizuar për asnjë punonjës të P.K. për shkak të mungesës së mjeteve financiare përveç shpërblimit jubilar. Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë duke përfshirë edhe neni 30 UA.nr.01/2021 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore nuk ka mundur të realizohet as pagesa e pagës së fund vitit. Sipas të paditurës, e paditura ndaj paditësit të vetmin detyrim ligjor e ka përmbushjen e Kontratës së Punës e cila konsiderohet ligj për palët. Paditësi do të mund të kompensohet për kërkesën e tij brenda mundësive institucionale ligjore dhe financiare deri më tani këto mundësi nuk janë krijuar, që nënkupton se nuk është detyrim për të paditurën. Bazuar nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës, që pas administrimit të provave të merr aktgjykim duke e refuzuar në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi që nga data 11.11.2019, është në marrëdhënie pune pranë P.K. me orar të plotë.

Gjykata përmes vërtetimit të punësimit me numër të referencës 05/3-04SRR/A/00047/2024, të datës 26.01.2024, vërtetoi faktin se paditësi A.G. është i punësuar me orare të plotë në P.K. e Kosovës dhe për punën që e kryen pranë të paditurës merr pagën prej 534.18 euro, në muaj. Po ashtu përmes formularëve të vlerësimit të performancës për vitin kalendarik 2020, 2021, 2022 dhe 2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.G. ka pasur vlerësim të përgjithshëm, me notën 4.00, që korrespondon me vlerësimin plotësisht i kënaqshëm.

Vërtetimin si dhe formularët e lartcekur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj. Andaj vërtetimit me të cilin është konstatuar se paditësi është në marrëdhënie pune pranë të paditurës dhe lartësia e pagës mujore të tij, si dhe formularëve me të cilët është bërë vlerësimi i punës së paditësit për vitet kalendarike 2020, 2021, 2022 dhe 2023, gjykata ia fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076, për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 ku përcaktohet se: *“I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*. Në nenin 44 par.2 të Ligjit Nr. 04/L-076, për Policinë përcaktohet se: *“Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*. Ndërsa neni 55 par.1 nënpar.1.7 i këtij Ligji përcakton se: *“Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*. Në nenin 5 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se: *“Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*, ndërsa në pikën 2 të këtij paragrafi parashihet *“Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”*. Ndërkaq në nenin 29 paragrafi 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*, ndërkaq bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, për Shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikimin shkollor dhe pagën jubilarë në policinë e Kosovës është paraparë se *“në kontestet nga marrëdhëniet e punës - lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e*

*Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021”.*

Në rastin konkret Gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit A.G. nga Prizreni, si i punësuar pranë saj, të ia paguaj pagën e 13-të për çdo fund vit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit, siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi për vitin 2020 dhe 2021, ka qenë me notën 4.00, që korrespondon me vlerësimin plotësisht të kënaqshëm, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, për pjesën aprovuese si në dispozitivin nën I dhe II të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit për këtë pjesë është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2021, i datës 29.09.2021, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese sikurse në pikën III të këtij aktgjykimi, për kërkesën e palës që në emër të kompensimit të pagës së 13-të, për vitin 2022 dhe 2023, në shumën e përgjithshme prej 1,068.36 €, vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e pagave të 13-ta për vitin 2022, dhe 2023, pasi që sipas Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, në nenin 30 par. 2 parashihet *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të viti, nëse ka mjete buxhetore”*. Sipas vlerësimit të Gjykatës dispozitat e lartcekur e udhëzimit administrativ lidhur me pagesën e pagës së 13-të, nuk janë norma të karakterit detyrues, andaj është plotësisht në vullnetin e punëdhënësit që duke vlerësuar mundësit buxhetore, të iu kompensohet paga e 13-të punëtorit. Në rastin konkret, gjykata vendosi që ta refuzojë kërkesën për kompensimin e pagës së 13-të për vitin 2022 dhe 2023, pasi që e paditura me përgjigje në padi ka njoftu se nuk ka mundësi buxhetore dhe se paditësi nuk ka prezantuar prova materiale për të vërtetuar mundësitë buxhetore të të paditurës. Andaj, meqenëse këtu e paditura nuk ka planifikim buxhetor të veçantë, që punëtorëve të iu kompensohen pagat e 13-ta dhe ka mjete të

kufizuara buxhetore, gjykata vlerësoi se në këtë drejtim nuk mund ta detyroj të paditurën për kompensimin e pagës së 13-të për vitin 2022 dhe 2023.

Në këtë drejtim Gjkata duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, për zbatimin e Udhëzimit Administrativ nr.01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, për kompensimin e pagës së 13-të për vitin 2022, erdhi në përfundim se në mungesë të mjeteve buxhetore, si kusht i cili duhej të plotësohej për tu mund të aprovohej kërkesëpadia e paditëses sipas dispozitave ligjore në fuqi, vendosi sikurse në dispozitivin nën III të këtij aktgjykimi, ashtu që kërkesëpadia e paditësit për pagën e 13-të për vitin 2022 dhe 2023, u refuzo në tersi si e pabazuar.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjkata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Meqenëse e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kamatë vonesa të jetë prej 8%, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (27.03.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas kërkesës së palës paditëse, për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore shumë prej 30 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme 134.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
C. nr.1891/2024, me datë 22.01.2025

B. profesional  
Ilir Sërtollaj

Gjyqtari  
Atdhe Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.